

SHTOJCA 2**RREGULLORE PËR ÇERTIFIKIMIN E SISTEMEVE TË MENAXHIMIT TË SHËRBIMIT TË IT
(TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT) NË PËRPUTHJE ME STANDARDIN ISO/IEC 20000-1:2018****2.1 TË PËRGJITHSHME**

2.1.1 Kjo rregullore përcakton procedurat plotësuese/ose zëvendësuese, të aplikuara nga FISA për certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit të Shërbimeve IT (teknologjia e informacionit) relativisht rregullave që tashmë janë përcaktuar në rregulloren e përgjithshme për certifikimin e sistemeve të menaxhimit.

Pikat e këtyre rregulloreve u referohen pikave përkatëse të rregullores së përgjithshme për certifikimin e sistemeve të menaxhimit për të cilat janë bërë ndryshime dhe/ose shtesa.

2.1.2 FISA lëshon certifikimin në përputhje me kërkesat e SSH EN ISO/IEC 17021: 2015, ISO/IEC 20000-6: 2017 për organizatat, sistemi i menaxhimit të shërbimit IT të të cilave është në përputhje me të gjitha kërkesat e Standardit ISO/IEC 20000-1: 2018.

2.1.3 Terminologjia e përdorur në këtë rregullore është ajo e pasqyruar në ISO / IEC 20000-1: 2018, ISO / IEC 20000-6: 2017 dhe SSH EN ISO / IEC 17000: 2005

2.2 STANDARDET REFERUES / KËRKESAT PËR CERTIFIKIM

(Pika 6.2, 6.3 e rregullores së përgjithshme të certifikimit të SM)

2.2.1 Për të marrë certifikimin nga FISA, Sistemi i Menaxhimit të Shërbimit IT duhet fillimisht dhe në vazhdimësi të plotësojë kërkesat e Standardit ISO/IEC 20000-1: 2018 dhe ato shtesë, të parashikuar nga organet e akreditimit.

2.3 SPECIFIKAT PËR ORGANIZATAT ME SHUMË VENDNDODHJE

(Pika 6.4 e Rregullores së përgjithshme të Certifikimit të SM)

2.3.1 Përveç dispozitave të Rregullores së Përgjithshme për Çertifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, kompania duhet të sigurojë gjithashtu një hartë të gjendjes së përgjegjësisë për mbikqyrjen e proceseve të menaxhimit të shërbimit të parashikuar nga standardi, në mënyrë që të lejojë verifikimin e përputhshmërisë e të gjithë këtyre proceseve.

Funksioni qendror i kompanisë duhet të menaxhojë gjithashtu rishikimin e katalogut të shërbimeve.

2.4 CERTIFIKIMI FILLESTAR

(Pika 6.5.1 e Rregullores së përgjithshme të Certifikimit të SM)

2.4.1 Përveç dispozitave të Rregullores së Përgjithshme për certifikimin e sistemeve të menaxhimit, kompania duhet t'i komunikojë FISA-s nëse sistemi i menaxhimit të shërbimit përfshin

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+1, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

dokumentacion (procedura, regjistrime, etj.) të

klasifikuara si "i rezervuar" dhe/ose në çdo rast është i padisponueshëm për qëllime certifikimi. S rrjedhojë, FISA do të vlerësojë situatën e krijuar, për të vazhduar procesin e certifikimit.

2.4.2 Së bashku me kërkesën për certifikim, ose më vonë për ricertifikim, kompania duhet të vërë në dispozicion të FISA edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- katalogu i shërbimeve të IT-së;
- arkitektura e rrjetit dhe sistemeve të informacionit.

2.5 PEZULLIMI, RIKTHIMI DHE TËRHEQJA E ÇERTIFIKIMIT

(Pika 6.8 e Rregullores së Përgjithshme të Certifikimit të SM)

2.5.1 Përveç dispozitave të Rregullores së Përgjithshme për Çertifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, pezullimi i vlefshmërisë së certifikatës bëhet publike nga FISA drejtpërsëdrejti në faqen e internetit www.fisa.pro.

2.5.2 Përveç dispozitave të Rregullores së Përgjithshme për Çertifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, rikthimi i certifikatës i njoftohet me shkrim kompanisë dhe bëhet menjëherë publike drejtpërsëdrejti në faqen e internetit www.fisa.pro.

2.5.3 Përveç dispozitave të Rregullores së Përgjithshme për Çertifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, tërheqja e certifikatës së konformitetit i njoftohet me shkrim organizatës dhe bëhet i ditur publikisht.

2.6 TRANSFERIMI I CERTIFIKATËS SË AKREDITUAR

(Pika 6.12 e Rregullores së përgjithshme të Certifikimit të SM)

2.6.1 Përveç dispozitave të rregullores së përgjithshme për certifikimin e sistemeve të menaxhimit, nëse një organizatë, me certifikim të vlefshëm të lëshuar nga një organ tjetër certifikimi i sistemeve të menaxhimit të shërbimeve të IT-së, dëshiron të transferojë certifikimin e saj te FISA, ajo duhet të dërgojë "Formularin e aplikimit ", në të cilën duhet të specifikojë arsyet e kërkesës për transferim. Në rast se certifikimi i lartpërmendur është lëshuar nga një organizëm certifikues i akredituar sipas marrëveshjes së njohjes reciproke IAF/MLA, FISA do të vlerësojë ekzistencën e kushteve për transferimin rast pas rasti.

2.7 HEQJE DORË NGA CERTIFIKIMI

(Pika 6.8 e Rregullores së Përgjithshme të Certifikimit të SM)

Përveç dispozitave të Rregullores së Përgjithshme për Çertifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, FISA përditëson statusin e vlefshmërisë së certifikatës brenda një muaji nga data e komunikimit të heqjes dorë nga certifikimi.